

Në bazë të nenit 172 të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 82/2018), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, shpallet

### **KONKURS**

për zgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore dhe në thirrjet të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës

Shpallet Konkurs për zgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore dhe në thirrjet të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës:

#### **FAKULTETI I TEKNOLOGJISË USHQIMORE DHE TË USHQYERIT**

1. Një asistent për lëndët mësimore në fushën e teknologjisë ushqimore.

#### **FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE**

1. Një mësimdhënës për lëndët mësimore në fushën e mjekësisë së përgjithshme;
2. Një asistent për lëndët mësimore në fushën e mjekësisë së përgjithshme.

#### **FAKULTETI FILOLOGJIK**

1. Dy mësimdhënës për lëndët mësimore në fushën e gjuhës gjermane;
2. Një mësimdhënës për lëndët mësimore në fushën e gjuhës shqipe.

#### **FAKULTETI I SHKENCAVE TË ZBATUARA**

1. Dy asistentë për lëndët mësimore në fushën e arkitekturës;
2. Një asistent për lëndët mësimore në fushën e ndërtimtarisë.

#### **FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE**

1. Një mësimdhënës për lëndët mësimore në fushën e kimisë;
2. Dy asistentë për lëndët mësimore në fushën e matematikës;
3. Një asistent për lëndët mësimore në fushën e informatikës;
4. Një asistent për lëndët mësimore në fushën e ekonomisë;
5. Një mësimdhënës për lëndët mësimore në fushën e informatikës.

#### **FAKULTETI EKONOMIK**

1. Një mësimdhënës për lëndët mësimore në fushën e turizmit;
2. Një mësimdhënës për lëndët mësimore në fushën e financave;
3. Një asistent për lëndët mësimore në fushën e ekonomisë.

## **FAKULTETI FILOZOFIK**

1. Një asistent për lëndët mësimore në fushën e historisë.

## **FAKULTETI PEDAGOGJIK**

1. Një mësimdhënës për lëndët mësimore në fushën e pedagogjisë;
2. Një mësimdhënës për lëndët mësimore në fushën e edukimit special.

### **Kushtet për thirrjen mësimore-shkencore docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar:**

- Thirrje mësimore – shkencore, me Vendim të organit kompetent, nëse e posedon;
- Diplomë për gradën shkencore doktor i shkencave nga fusha shkencore në të cilën zgjidhet;
- Kandidatët që konkurrojnë duhet të kenë kontinuitet në studimet nga fusha përkatëse;
- Listë të punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara, si dhe kopje të punimeve të publikuara;
- Biografi e shkurtër;
- Ta dorëzojë punimin e doktoratës;
- Vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj;
- Njohje të gjuhës shqipe - shkrim dhe lexim;
- Certifikatë nga libri amë i të lindurve;
- Certifikatë e shtetësisë.

### **Kushtet për thirrjen e bashkëpunëtorit:**

- Diplomë për kryerjen e arsimit të lartë dhe marrjen e gradës shkencore magjistër i shkencave nga fusha shkencore në të cilën zgjidhet;
- Kandidatët që konkurrojnë duhet të kenë kontinuitet në studimet nga fusha përkatëse;
- Listë të punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara, si dhe kopje të punimeve të publikuara;
- Biografi e shkurtër (CV);
- Ta dorëzojë punimin e magistraturës;
- Vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj;
- Njohje të gjuhës shqipe - shkrim dhe lexim;
- Certifikatë nga libri amë i të lindurve;
- Certifikatë e shtetësisë.

\*Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore dhe të bashkëpunëtorëve, të parapara me nenet 166 dhe 170 të Ligjit për arsimin e lartë.

\*Fletëparaqitjen bashkë me dokumentet e nevojshme, kandidati duhet t'i dorëzojë në afat prej 5 ditë pune, nga dita e shpalljes së Konkursit, në Rektoratin e Universitetit të Tetovës, në adresën: Rektorati i Universitetit të Tetovës, Rr. e Ilindenit, p.n. Tetovë.

**Universiteti i Tetovës**